



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 218, Datë 23. 02 .2012**

**“Për  
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar  
ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |   |         |             |         |
|---|---------|-------------|---------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Servete | GRUDA       | Anëtar  |
| • | Koço    | BROKA       | Anëtar  |
| • | Rezana  | KONOMI      | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 23.02.2012, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Hapja e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

**Baza ligjore:** Nenet 24, shkronja d); 26; 28, shkronja b); neni 4, pika 1; dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës;

## **VËREN SE:**

1. Në media, është botuar letra e plotë në emër të dy shoqërive të shërbimeve portuale në Portin e Vlorës, përkatësisht “Alpida” shpk dhe “Delfini 1” shpk ku bëjnë me dije se agjencitë detare të cilat përfaqësojnë respektivisht tragetet “Ioninan Spirit” dhe “Red Star 1” të cilët janë të vetmit tragete që operojnë në linjën Vlorë - Brindisi – Vlorë. Sipas kësaj deklarate këto agjenci kanë ndërprerë shërbimin gjatë vitit të kaluar, kanë aplikuar një grafik udhëtimi të përbashkët duke operuar një ditë njëri traget një ditë tjetri, si dhe çmime tepër të larta për linjën Vlorë - Brindisi - Vlorë.
2. Gjatë monitorimit të kryer nga Sektori i Analizës dhe Studimeve të Autoritetit të Konkurrencës gjatë muajit Qershor 2011 me nr. 193 prot. datë 18.07.2011 është vënë re se tregu i shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës ka një shkallë të lartë përqëndrimi pasi operojnë vetëm dy tragete për linjën Vlorë-Brindisi-Vlorë.
3. Gjatë muajve Mars, Prill dhe Qershor 2011 në këtë linjë është ndërprerë disa herë qarkullimi i udhëtarëve nga njëri prej trageteve ose nga të dy njëkohësisht. Gjatë periudhës së mungesës së udhëtimeve nga trageti “Jonian Spirit” është vënë re rritje e çmimit biletës së tragecit tjetër, por gjithësesi pa kaluar tarifën e përcaktuar në Licencë.
4. Bazuar respektivisht në nenet 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, situatua e krijuar në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës mund të ketë ardhur si pasojë e një marrëveshje të ndaluar ose një praktike përjashtuese të ndërmarrjeve që mund të ekzistojnë pozitivisht dominuese të ndjekura nga një ose disa ndërmarrje.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

## **V E N D O S I:**

- I. Hapjen e e procedurës së hetimit praparak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, për

të parë nëse ka, apo jo, shenja të pengimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës.

- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 30.04.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Rezana Konomi**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R**